



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:185974
Datë: 05.07.2024
Numri i dokumentit: 05904777

C.nr.2541/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve-propozuesve të sigurimit I. K., I. K. N.K., I. K., V.K. dhe M. K., të gjithë nga komuna e Mitrovicës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokatia Juridika, me avokat Skender Musa nga Prishtina, Rr."Richard Holbrooke", Hyrja., nr..., kundër të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit U. H., N. H. dhe Sh. H., të gjithë me vendbanim në komunën e M., me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, jashtë seancës, më datë 04.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET** si i pabazuar propozimi i paditësve-propozuesve të sigurimit I. K., I. K. N.K., I. K., V.K. dhe M. K., të gjithë nga komuna e M., me të cilin kanë kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit me të cilën i'u ndalohet të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit U. H., N. H. dhe Sh. H., të gjithë me vendbanim në komunën e M., që të tjetërsojnë, ngarkojnë, fshehin apo disponojnë si dhe të kryejnë aktivitete me qëllim të ruajtjes në ngastrat si në vijim: ngastra me nr.1051/0 me sipërfaqe 7 ari; ngastra me nr.1051/0 me sipërfaqe 34 ari e 65 m²; ngastra me nr.1055/0 me sipërfaqe 2 ha, 99 ari, 57 m²; ngastra me nr.1053/0 me sipërfaqe 32 ari, 05 m²; ngastra me nr.1054/0 me sipërfaqe prej 21 ari 62 m²; ngastra me nr.1079/0 me sipërfaqe 1 ha, 51 ari, 64 m², të cilat gjenden në fshatin P., komuna e M. deri në përfundimin e plotëfuqishëm të kontestit.

- II.** Procedura në këtë çështje juridike do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës, duke marrë parasysh prioritetin e këtij kontesti.

A r s y e t i m

Paditësit - propozuesit e sigurimit I. K., I. K. N.K., I. K., V.K. dhe M. K., të gjithë nga komuna e M., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, në këtë gjykatë kanë ushtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, kundër të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit U. H., N. H. dhe Sh. H., të gjithë me vendbanim në komunën e M.

Në propozimin e ushtruar propozuesit e sigurimit i kanë propozuar gjykatës që të caktojë masën e përkohshme të sigurisë me të cilën i'u ndalohe të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit U. H., N. H. dhe Sh. H., të gjithë me vendbanim në komunën e M, që të tjetërsojnë, ngarkojnë, fshehin apo disponojnë si dhe të kryejnë aktivitetet me qëllim të ruajtjes në ngastrat si në vijim: ngastra me nr.... me sipërfaqe 7 ari; ngastra me nr....0 me sipërfaqe 34 ari e 65 m²; ngastra me nr.... me sipërfaqe 2 ha, 99 ari, 57 m²; ngastra me nr.... me sipërfaqe 32 ari, 05 m²; ngastra me nr.... me sipërfaqe prej 21 ari 62 m²; ngastra me nr.... me sipërfaqe 1 ha, 51 ari, 64 m², të cilat gjenden në fshatin P., komuna e M., deri në përfundimin e plotëfuqishëm të kontestit.

Propozimin për caktimin e masës së përkohshme, paditësit-propozuesit e sigurimit e kanë arsyetuar me atë se të njëjtit e kanë bërë të besueshme ekzistimin e kushteve për caktimin e masës së sigurisë. Sipas të njëjtëve, moscaktimi i masës do të ndikojë në mënyrë negative në realizimin e të drejtës së tyre, pasi që propozuesit e sigurimit janë duke u përballur me probleme për regjistrimin e kësaj paluajtshmërie si dhe shfrytëzimin e saj. Në fund ka kërkuar caktimin e masës nga neni 301 i LPK-së.

Me dispozitën e nenit 297 par.1, pika a) dhe b) të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), parashihet se: *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij”*,

ndërsa me dispozitën e nenit 306 par.1 të LPK-së është paraparë se: *“Me propozimin e propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktoj masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit po që se propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit.”.*

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit si dhe provave të bashkangjitura vlerësoi se në rastin konkret propozimi i propozuesve të sigurimit, për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit nuk është i bazuar ngase propozuesit e sigurimit me asnjë provë nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive të tyre dhe as ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të propozuesve. Respektivisht në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë e cila provon se propozuesit janë pasardhës të të ndjerit R. K., pastaj propozuesit, propozimit nuk i kanë bashkangjitur asnjë provë e cila provon ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurisë palës kundërshtarë do t’i pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës apo të drejtës subjektive të tij.

Bazuar në dispozitat e lartëcekura ligjore, për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kushtet e parapara me dispozitën e nenit 297 par.1 të LPK-së, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, andaj meqënëse në rastin konkret, paditësit-propozuesit e sigurimit, padisë respektivisht propozimit të parashtruar nuk i kanë bashkangjitur asnjë provë me të cilën provojnë plotësimin e kushteve të lartëcekura, vendosi të refuzojë propozimin e propozuesve të sigurimit, duke vlerësuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e parapara me dispozitën e nenit 297 par.1, pika (a) dhe (b) lidhur me nenin 306 par.1 të LPK-së, për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.2541/24 më datë 04.07.2024

Gj y q t a r j a

Numri i lëndës: 2024:185974
Datë: 05.07.2024
Numri i dokumentit: 05904777

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.